

BULETINI TREMUJOR

Nr. 44 - VITI XI - TM4 2018

FONDI I KURSIMEVE PENSIONALE I KOSOVËS

TRUSTORJA

PERFORMANCA

PERIUDHA	1M	3M	1V	3V	5V	NGA THEMELIMI
REZULTATI	-3.19%	-6.17%	-5.28%	5.35%	14.51%	38.75%
BENÇMARKU*	0.87%	1.65%	2.95%	4.80%	4.14%	37.39%

*INDEKSI I HARMONIZUAR I ÇMIMEVE TË KONSUMIT I PUBLIKUAR NGA AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS

LËVIZJET MUJORE

ÇMIMI I AKSIONIT:

TETOR	▼ -3.49%
NËNTOR	▲ +0.42%
DHJETOR	▼ -3.19%
TREMUJORI	▼ -6.17%

KTHIMI BRUTO [euro]

TETOR	-60.50 mln
NËNTOR	7.74 mln
DHJETOR	-54.38 mln
TREMUJORI	-107.14 mln

KTHIMI NETO [euro]

TETOR	-61.16 mln
NËNTOR	7.11 mln
DHJETOR	-55.03 mln
TREMUJORI	-109.08 mln

KONTRIBUIMI

KONTRIBUTE TË REJA [euro]

TETOR	16.62 mln
NËNTOR	14.16 mln
DHJETOR	15.09 mln
TREMUJORI	45.87 mln

LLOGARI TË REJA

TETOR	2,945
NËNTOR	2,634
DHJETOR	3,406
TREMUJORI	8,985

LLOGARI AKTIVE

TETOR	331,537
NËNTOR	337,355
DHJETOR	344,453
TREMUJORI	306,475

PENSIONIMET

PËRFITUES PENSIONI

TETOR	425
NËNTOR	372
DHJETOR	273
TREMUJORI	1,070

VLERA E TËRHEQUR

TETOR	€1.81 mln
NËNTOR	€1.67 mln
DHJETOR	€2.58 mln
TREMUJORI	€6.06 mln

ARSYET

PENSION MOSHE	RASTE VDEKJESH	TË TJERA
€1.43 mln	€0.34 mln	€0.04 mln
€1.23 mln	€0.42 mln	€0.02 mln
€2.36 mln	€0.18 mln	€0.04 mln
€5.02 mln	€0.94 mln	€0.10 mln

PËRMBLEDHUR

	TM4	TM3
ÇMIMI I AKSIONIT	€1.3875	€1.4788
MJETET NËN MENAXHIM	€1,682,023,592	€1,753,263,931
TARIFA INVESTUESE	€1.64 mln	€1.66 mln
TARIFA OPERACIONALE	€0.31 mln	€0.31 mln
INVESTIMET NË KOSOVË	€328.45 mln	€248.53 mln
INVESTIMET JASHTË	€1,353.58 mln	€1,496.93 mln
TË PAINVESTUARA (NË BQK)	€126.26 mln	€7.80 mln
LLOGARI NË eTRUSTI	102,727	96,667
SHËRBIMET E OFRUARA	21,767	21,543



KREATIVITET
ORGANIZIM
DREJTIM
- JETË!

PLASMANET DHE PERFORMANCA

MENAXHUESI/ FONDI / BANKA	EMËRTIMI I FONDIT	PLASMANET FUNDI TM4 (€)	PJESËMARRJA MESATARE	PERFORMANCA MESATARE	KTHIMI BRUTO NË INVESTIME (€)
Vanguard	Global Stock Index Fund - Euro	€363,676,626	23.54%	-15.23%	-57.84 mln
Nordea	1-Stable Return Fund	€124,005,629	7.91%	-3.16%	-4.88 mln
Nordea	1-Global Stable Equity Fund	€162,607,446	6.70%	-11.01%	-15.33 mln
BNY Mellon	Global Real Return Fund	€145,256,365	6.59%	-1.29%	-1.02 mln
AXA	Global Inflation Linked Bonds	€97,593,865	5.89%	-0.71%	-0.22 mln
AXA	WF Optimal Income I EUR	€53,906,903	6.50%	-9.16%	-10.08 mln
Schroders	ISF Global Diversified Growth	€55,893,343	6.65%	-8.16%	-8.35 mln
Amundi	Rendement Plus Part I2	€102,509,778	6.92%	-3.58%	-3.98 mln
Amundi 3M	Amundi 3M - I	€59,847,864	3.60%	-0.07%	-0.04 mln
BNP Parvest	Diversified Dynamic	€52,220,239	6.47%	-6.49%	-6.96 mln
Schroders	Strategic Bond - Euro Hedged	€9,812,299	0.61%	-3.01%	-0.03 mln
Thesari i Kosovës*	Obligacione	€168,156,013	9.55%	0.54%	0.86 mln
Thesari i Kosovës*	Fletobligacione	€40,888,274	2.71%	0.11%	0.05 mln
BKT, BPB, TEB, NLB*	Depozita me afat	€119,403,795	4.04%	1.45%	0.27 mln
BQK - të gatshme	Të painvestuara	€126,245,153	2.31%	-0.07%	-0.03 mln
N/A	N/A				**0.70 mln
GJITHSEJ		€1,682,023,592	100.00%	-6.17%	-107.14 mln

*Performanca është e bazuar në norma fikse të interesit.

** Të hyra të tjera.

LAJME

PERFORMANCA PËR 2018 NEGATIVE NGA INVESTIMET POR NË AFATGJATË NUK PREKEN KONTRIBUESIT

FKPK ka filluar vitin 2018 me mjete nën menaxhim prej 1,634,648, 056 euro dhe e ka përfunduar atë me 1,681,148,925 euro, ose me 46,500,869 euro më shumë. Gjatë këtij viti FKPK-ja po ashtu ka shpëruar shumën prej rreth 31.2 milionë për kontribuuesit e pensionuar.

Performanca e investimeve gjatë vitit 2018 ishte -5.2%, që erdhi pas kthimit në investime prej +6.48% për vitin 2017. Po ashtu duhet sqaruar se deri në vitin 2018 ishin 9 vjet të rezultateve pozitive të njëpasnjëshme nga investimet me një kthim bruto të akumuluar prej 464.8 milionë euro.

EMËROHEN PESË ANËTARË TË BORDIT DREJTUES

Kuvendi i Kosovës, në seancën e mbajtur më 2 nëntor 2018, ka emëruar pesë anëtarë të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës. Nga këto pozita katër ishin profesionale dhe një pozitë ishte për përfaqësimin dhe këshillimin e të punësuarve. Mandati i të emëruarve është 4-vjeçar me mundësi rizgjedhjeje, duke filluar nga 1 dhjetori 2018.

Në pozitën e Kryesuesit të Bordit është emëruar z. Ruzhdi Morina, që njëkohësisht është anëtar profesional në Bord. Për tri pozitat e tjera profesionale Kuvendi i ka emëruar: z. Frederick Artesani, z. Behxhet Haliti dhe z. Driton Qehaja. Kurse në pozitën e përfaqësimit dhe këshillimit të të punësuarve është emëruar z. Ymer Ymeri.

BORDI ZHVILLOI KATËR TAKIME GJATË TM4: NJË NË TETOR, NJË NË NËNTOR DHE DY NË DHJETOR

Bordi Drejtues në mbledhjen e tetorit 2018 ka shqyrtuar gjendjen e të gjitha investimeve dhe fondeve investuese, dhe për shkak të situatës së paqëndrueshme në tregjet financiare, si dhe zhvillimeve të pritshme, Bordi vendosi të ndërmarr masa për uljen e riskut investues, duke drejtuar mjetet nga fondet më konservative. Në këtë linjë u tërhoqën: €21 mln nga Nordea SRF; €42 mln nga Amundi RP; €43 mln nga Schroders GGG; €47 mln nga AXA-OI; dhe €50 mln nga BNP Parvest. Në anën tjetër, këto mjete të tërhequra u vendos t[investohen si në vijim: €21 mln në Nordea GSE; €85 mln në BNY Mellon dhe €97 mln në Amundi 3M-I.

Në mbledhjen e nëntorit Bordi vendosi të shtonte mjetet e FKPK-së në depozitat bankare në vend, duke i depozituar €88 mln, përfshirë këtu edhe ato që maturojnë. Po ashtu Bordi e miratoi propozimin për vazhdimin e pjesëmarrjes në ankandet e letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës.

Në mbledhjen e 13 dhjetorit 2018, Bordi u konfirmua në përbërjen e re, ku pesë anëtarë u mandatuan në Kuvendi i Kosovës. Me këtë rast u përcaktuan edhe komisionet e Bordit dhe kryesuesit e anëtarët përkatës të tyre.

Kurse më 27 dhjetor 2018, Bordi unanimisht miratoi vendimet për tërheqjen e fondeve në vijim: nga BNP Parvest €40 mln; nga Schroders GGG €40 mln; dhe nga AXA OI €40 mln. Në anën tjetër, këto tërheqje u vendos të plasohen si në vijim: në Amundi 3M €45 mln; në BNY Mellon €30 mln; në Nordea GSE €30 mln dhe do të kthehen në BQK €15 mln.

BOTUES

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës
Shkurt 2019

AUTOR

Jeton Demi

ADRESA

Rr. "Agim Ramadani" #182-184
10000 Prishtinë, Kosovë

E-MAIL DHE UEB

info@trusti.org
www.trusti.org

